



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 060/01-25025/22  
Kaçanik, 02.09.2022

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 02 shtator 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan me arsyе, Rrustem Zenuni dhe Rabije Sallahi.

Prej ekzekutivit të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Drejtoret e drejtive: Qamil Stagova- DUKMM, Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu-DSHMS, Izahir Doda- DA, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Suad Dullovi- DBPZHR dhe Dardana Tafili-Dauti- DAP, ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Fatlume Guri-Selimi dhe Bejtulla Dalloshi.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroi Faruk Dermaku

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoi, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Arbnora Kuka.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezantë janë 23 anëtarë, ndërkohë Fitore Vishi edhe Arlinda Rakoci-Raka do t'i bashkëngjiten mbledhjes. Kushte pune për mbajtjen e mbledhjes kemi, kështu që e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, data 02 shtator, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të komunës;
2. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/02-12630/2022 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në emër të Nexhmedin Elezi nga f. Sllatinë;
3. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimi e Vendimit 01Nr. 06-350/02-13415/22 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në emër të Blerim Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet;
4. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës; dhe
5. Përgjigje nga MBPZHR në kërkesën e Kuvendit të komunës, të datës 28.07.2022, lidhur me rishqyrtimin e vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit 01Nr.60/06-350/02-16605/22, të datës 27.06.2022.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutim:

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime nuk ka, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

### APROVON

#### **Rendin e punës në përbërje prej 5 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, nëse keni diçka urdhëroni.

**z.Adnan Reka:** Përshëndetje për të gjithë, kam një vërejtje te pika 4. Propozim Vendim paraprak për dhënien e pronë së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë në procesverbal. Kam thënë a nuk ishte kjo parcelë , por nuk e kam përmendur numrin e parcelës, se nuk e di. Të fshihet numri i parcelës të tjerat janë në rregull.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK , me këtë vërejtje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

### APROVON

**Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës (mbledhjes se 7 të rregullt), të datës 28.07.2022 / Lënda: 01Nr.60/01-20610/22.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave;

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**z. Adnan Reka:** Kam një pyetje për Drejtorin e DSHPE. A mund të na tregoni në Bulevardin “Ismail Raka”, cili është projekti që po zhvillohet rreth lumit “Nerodime” dhe cili është plani pas prishjes së objektit të Qendrës për Punë Sociale? Mund të ktheni përgjigje me gojë ose me shkrim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori nuk është këtu por do t’i përcjellët pyetja. Dikush tjetër nëse keni pyetje.

**z. Agim Mani:** Përshëndetje për të gjithë. Kemi pasur raste të shumta të simptomave të ujit të kontaminuar. Sipas IKSHPK nga mostrat e ujit të marra, analizat bakteriologjike, kanë treguar se këto mostra nuk i plotësojnë standarde të ujit të pijshëm. A keni arritur të evidentoni defektet në këto rajone që keni pasur probleme? Nuk kamë parë asnje njoftim publik që komuna ka dal me komunikatë sa i përket këtij evidentimi .Ky ujë shkakton probleme shëndetësore tek qytetarët.

Pyetja dytë është për DSHPE. A keni ndonjë kriter për vendosjen e pengesave në rrugë , kur KKSB del me rekomandime që aty ku ka trotuar, të hiqen pengesat në rrugë, ndërsa ju i vendosni edhe aty ku janë dy anët trotuar .Përveç kësaj i kushton edhe buxhetit të komunës njëherë t’i vendosni pastaj t’i rrënoni.

**z. Agim Çaka:** Përshëndetje për të gjithë. Kam një pyetje lidhur me punët në hekurudhë. A ka mundësi komuna të ndërhyjë në projekt? Shpesh herë kemi paraqitur problemi e hekurudhës si rrezik potencial për këmbësorët, me laura që i kemi në qytet. A ka pasur interesim komuna rreth këtij projekti dhe a ka bërë kërkesë për ndërhyrje në këtë projekt?

**z. Betim Shala:** Përshëndetje për të gjithë. Edhe unë kam pyetje për hekurudhën. Për kanalizimet që janë të rrugës "Skënderbeu", të cilat dalin përtej hekurudhës. Kemi pyetur punë kryesin dhe ata kanë thënë se nëse nuk e kemi miratimin e komunës, nuk mund të bëjmë asgjë. Sa është e kyçur komuna në këtë projekt?

**znj. Ardita Rrahmani:** Përshëndetje për të gjithë. Përderisa po bëhem i gati për fillimin e procesit mësimor, pavarësisht se kur fillon, a ka paraparë diçka komuna për qasje më të lehtë dhe duke shmangur rrezikun për jetë në SHFMU "Emin Duraku" në "Dushkajë"? Kam fjalën për nënkalimin për arsyen se ajo rrugë është vështirë e qarkullueshme, jo vetëm gjatë stinës së dimrit por në të gjitha stinës.

**z. Naim Beqa:** Përshëndetje për të gjithë. Me sa di unë, në mbledhjen e parë të Kuvendit, kam këruar vendosjen e pengesave te "ETC" dhe kam këruar të vendoset një laurë në hekurudhë, për kalimin e nxënësve të shkollës filllore. A është ndërmarrë ndonjë hap nuk e di, por tash është rasti i komunës të bëjë kërkesë për realizimin e këtij projekti, pasi që aty është rrezik permanent për këto fëmijë.

**z. Betim Shala:** Kam edhe një kërkesë për Kryetarin. Sipas ligjit, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, 4 shtatori është afati i fundit për aplikim për legalizim, por është ditë e diele. Kërkojë që të lejohet të punojnë edhe atë ditë vetëm për pranimin e dokumenteve, pasi është dita e fundit.

**2. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/02-12630/2022 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në emër të Nexhmedin Elezi nga f. Sllatinë;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori i DUKMM është këtu. Ne kemi dërguar vendimet në shqyrtim të ligjshmërisë. Disa kanë kaluar ndërsa disa janë kthyer për rishqyrtim. Ato të cilat janë kthyer për rishqyrtim, jemi të obliguar sipas ligjit që të bëhet anulimi i vendimeve.

**z. Agim Mani:** Ne edhe në seancën e kaluar, kur është sjellë kërkesa në Kuvend në emër të Nexhmedin Elezit, nuk e keni sjellë të kompletuar, ashtu si keni vepruar me kërkesat tjera. Që në start pas bërges së kërkesës për ndërrim destinim të kësaj prone, ju si keni kryer të gjitha procedurat siç keni vepruar te pronat tjera. Në këtë rast nuk ka dal komisioni verifikues në vend të ngjarjes për të konstatuar që prona e propozuar për ndërrim destinim me numër të parcelës, se a është vërtetuar me certifikatën e pronës, dhe të verifikohet që kjo pronë a gjendet në këtë lokacion. Këtë nuk e keni sjellë në Kuvend. Dhe pa u siguruar mirë e keni hedhur në votim ku edhe deputetët i keni vendosur para aktit të kryer, të cilën e ka thënë edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që ky akt është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe sot ndoshta detyrohen të votojnë kundër vendimit që vet e kanë miratuar apo nëse mund të them që votojnë kundër vetes. Keni edhe sugjerim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, siç thotë: që Neni 11 paragrafi 11.2 të Ligjit 02/I-26 Për tokat bujqësore, ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozita tjera të bazuara në ligj. Dhe nen 11, paragrafi 11.4 i tokës bujqësore nga neni 10.5(a)dhe(b), nuk mund t'i ndërrohet destinimi tokës bujqësore dhe ajo nuk mund të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinor përkatesisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është caktuar destinim. Është mirë që pasi që jeni në përfundim siç thoni të planit hapësinor apo planit zhvillimor komunal, të futen të gjitha lokacionet aty ku është e ligjshme, duke u bazuar në rajone, në kërkesa të qytetarëve dhe me të vërtet të zgjidhni problemet e qytetarëve. Është një mundësi e mirë të futen në këtë plan zhvillimor dhe mos i vendosni përfaqësuesit e qytetarëve në Kuvendin komunal që shpesh herë të votojnë edhe kundër vendimeve të veta apo kundër vërvetes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket asaj që ne i qesim para aktit të kryer që duhet të vendosin të votojnë për apo kundër, kjo nuk është e drejtë apo në rregull për arsyen se ka plotë vendime të tjera të cilat ju i keni konsideruar të paligjshme, por ministria i ka vlerësuar të ligjshme. Por ka edhe plot prej atyre që janë kthyer në rishqyrtim dhe obligim imi ligjor është që ti rishqyrtojmë në Kuvend, sipas kërkësës së ministrisë. Edhe kur i kemi miratuar e kemi cekur, se ka raste që disa vendime të njëjtës natyrë kalojnë disa nuk kalojnë. Për tu bërë korrekt ndaj qytetarëve i përcjellim në ministri. Nuk ka diçka të keqe këtu. Keq është nëse ato që i kthen ministria në rishqyrtim nuk i sjellim në Kuvend. Jemi munduar ti ofrojmë zgjidhje qytetarëve. Po të ishin të rregulluara me Planin zhvillimor Komunal dhe me Planin hapësinor, ato lëndë nuk do të dilnin në Kuvend, por shkojnë në procedura të rregullta., por pasi nuk janë me plan i sjellin në Kuvend të trajtohen dhe si Kuvend të japim mendimin nëse i ndryshojmë ndërrimin e destinimit të tokave apo jo.

**z. Agim Mani:** Edhe herën e kaluar kam kërkuar që kjo kërkësë e Nexhmedin Elezit nuk është plotësuar sikur kërkësat tjera që kanë ardhur në Kuvend. Komisioni vlerësues nuk ka dal në vend të ngjarjes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Askund në kërkësë të MBPZHR nuk thuhet që nuk është e plotësuar, por thotë që nuk është e trajtuar në PZHK dhe Planin hapësinor.

**z. Adnan Reka:** Është keq që Kuvendi të merr vendime të gabuara, ajo reflektohet në pasqyrën e Kuvendit për punën që bëjmë. Vendimet që ne duhet t'i shfuqizojmë , është deshtë paraprakisht drejtoritë përkatëse t'i ndalojnë, mos t'i sjellin në Kuvend. Kjo na tregon që nuk kanë vëmendje të mjaftueshme ato që i sjellin vendimet këtu. Pastaj ne i marrim vendimet e gabuara dhe ministria na kthen dhe ne në procedura të rregullta i shfuqizojmë. Kjo është keq për neve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne po pajtohem me atë që është keq që kthehen. Është mirë që të mos shkojnë fare atje dhe të mos kthehen në rishqyrtim .Për atë që ne si Kuvend jemi keq me punën tonë , janë publike raportet e MAPL për çdo vit dhe jemi ndër Kuvendet me performancën shumë të mirë, ndër më të mirët , por edhe me më së paku rishqyrtim te vendimeve. Këto gjëra i bëjnë të gjitha kuvendet komunale, por edhe më shumë se ne. Ka Kuvende komunale që nuk i sjellin në rishqyrtim fare , por ka edhe prej atyre që janë në procedura gjyqësore.

**z. Qamil Stagova:** Më herët ka ndodhur që nëse një parcelë nuk ka qenë e paraparë për ndërtim me Plan Zhvillimor komunal, ministria e ka aprovuar vendimin e Kuvendit dhe ka vazhduar. Këtë vit nuk po ndodh kjo , dhe marrë zotimin që lëndë që mund të kthehen nga ministria nuk do t'i sjellim në shqyrtim.

**z. Adnan Reka:** Faleminderit drejtor që konfirmuat që nga ky vit nuk do të ndodhin kështu.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E përmirësoj pak drejtorin se para kësaj mbledhje janë konfirmuar vendimet të ligjshme, këtë vit.

**z. Agim Çaka:** Te kjo pikë po kemi vazhdimisht probleme, te ndërrimi i destinimit të tokës. Nuk është problemi as te ne as te ministria, por problemi më të madh e kanë qytetarët. Zakonisht ministria po jepin vërejtje te Plani zhvillimor komunal dhe te plani hapësinor. Kur do të rregullohet kjo punë dhe a është duke punuar dikush dhe ku ka ngecur problemi? Ne duhet si Kuvend komunal të dimë a i kemi rregulluar punët tona këtu, pastaj të kërkojmë aprovim nga ministria. Por ajo çka kërkon ministria është diçka që edhe ne duhet ta kërkojmë këtu. Ministria thotë të ndryshohet plani hapësinor, nëse doni të punoni diçka, me ec përpara. Në mënyrë që qytetarët kërkësat që i bëjnë, të jenë në përputhje me Planin zhvillimor dhe planin hapësinor. Dikush të jap përgjigje ku ka ngecur plani zhvillimor, kush është fajtor për të që nuk

ka ndryshuar, sepse qytetarët nuk mund t'i realizojnë kërkesat e tyre. Problemi është këtu , nuk është në ministri. Prapë po bëjë kërkesë , sepse kolegët e mi nuk kanë qenë në legjislacionin e kaluar dhe minden mos me pas njohuri se kush ka punuar në këtë drejtim, a është dikush përgjegjësi i komunës , a është ndonjë drejtor, apo Kryesuesi apo Kryetari përgjegjës për këtë plan?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket Planit Zhvillimor komunal, vitin e kaluar ka filluar komisioni takimet në pjesën ku ka mbetur. Problemi qëndron tek komisioni. Të paktën drafti i parë është dashur të jetë gati.

**z. Qamil Stagova:** Kérkojë që në mbledhjen e radhës të më lejohet të sjell draftin.

**z. Agim Çaka:** Nëse është problemi te komisioni, duhet të shkarkohet komisioni, të mos mbetemi peng i një komisioni apo individi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim, atëherë Kérkesën e MBPZHR për Rishqyrtimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/02-12630/2022 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në emër të Nexhmedin Elezi nga f. Sllatinë, e qes në votim dhe e njëjta u aprovua me **20 vota për** dhe **5 vota kundër, abstenim nuk ka**. Me këtë konstatoj që Kuvendi i komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Anulimin e Vendimit paraprak të KK 01Nr.06-350/02-12630/22 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në PK 01208-2, mal i klasës 3 në sipërfaqe 504 m<sup>2</sup> dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722 m<sup>2</sup>, pronë e Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga fshati Sllatinë/ Lënda 01Nr.104/02-22552/22.**

Për arsyet e konfliktit të interesit të Kryetarit të komunës lidhur me pikën 3 të rendit të punës, Kryetari e lëshon mbledhjen.

**3.** Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimi e Vendimit 01Nr. 06-350/02-13415/22 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në emër të Blerim Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përgjigjen e MBPZHR-së e keni, nëse keni diçka për diskutim, urdhëroni.

**z. Agim Mani:** Ne si grup i LVV i kemi shprehur shqetësimet tona, në këto raste për tokat bujqësore dhe rëndësinë e këtyre tokave bujqësore. Përkundër përkushtimit tonë dhe ruajtjes së tokës bujqësore dhe kur dihet që parcela në fjalë ka qenë e privatizuar për 99 vite nga AKP për qëllime bujqësore. Nuk besoj që AKP i ka privatizuar tokat pa kritere, që toka bujqësore të privatizohet dhe mandej të ju ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore dhe pastaj të jepet në shfrytëzim dhe të kontraktohet toka bujqësore për lokale afariste. Edhe nëse ka vepruar kështu AKP, ne jemi banor të kësaj komune dhe tokat tona bujqësore t'i mbrojmë në vete, pavarësisht interesave personale dhe duhet të veprojmë më shumë se kaq. Ne do ta votojmë ashtu si e kemi cilësuar më herët, kur na është sjellë në Kuvend ky propozim vendim dhe këtë na vërtetuan edhe organet e ligjshmërisë , gjegjësish Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që ne me të drejt i kemi dhënë votë kundër këtij propozim vendimi i cili ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**z. Betim Shala:** Në emër të LDK, vendimet që janë bërë për ndërrimin e destinimit të tokës kanë qenë në rregull. Nëse me plan do të ishte tokë ndërtimore, propozim vendimi nuk do të kishte ardhur në Kuvend, por pasi nuk ka qenë në plan zhvillimor tokë ndërtimore, atëherë atë

e kanë sjellë në Kuvend dhe Kuvendi ka marrë vendim për ndryshim të asaj pjesë. Çka nëse miratohet Plani i ri Zhvillimor komunal dhe pastaj në një vend parashihet një investim i madh , edhe ajo duhet të kthehet a?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk janë të trajtuara në Plan Zhvillimor Komunal. Tokat që janë në PZHK si tokë ndërtimore , drejt shkojnë në procedura. Nëse kalon Plani Zhvillimor Komunal në Kuvend, atëherë do të jemi në rregull. Nëse këto prona do të ishin në plan zhvillimor komunal toka ndërtimore nuk ka nevojë të dilnin në Kuvend, por ne duhet të përballemi.

Nëse nuk keni diçka tjetër Kërkesën e MBPZHR për Rishqyrtimi e Vendimit 01Nr. 06-350/02-13415/22 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në emër të Blerim Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet e qes në votim për miratim dhe e njëjtë aprovohet me **20 vota Për, vota Kundër dhe Abstenim nuk ka**. Me këtë konstatoj që Kuvendi i komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për Anulimin e Vendimit të KK 01Nr.06-350/02-13415/22 të datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në sipërfaqe 350 m<sup>2</sup>, në PK 02302-2 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore arë e klasës 5, pronë e Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër/ Lënda 01Nr.104/02-22551/22.**

**4.** Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket këtij komisioni, i kemi emrat e 4 anëtarëve të propozuar në mbledhjen e kaluar, nevojitet vetëm edhe emri i anëtarit nga Shoqëria civile. Për arsyen e konfliktit të interesit të Kryetarit që kishte lidhur me pikën 3 të rendit të punë, Kryetari e lëshoi mbledhjen. Kryetari e ka propozimin nga Shoqëria civile për Naim Hysa, por nëse ka nevojë e ftojmë Kryetarin prapë në mbledhje. Nëse keni diçka për diskutim urdhëroni.

**znj. Ardit Rrahmani:** Sipas nenit 27 të Rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, thotë se mbikëqyrja e tokave të dhëna në shfrytëzim bëhet nga drejtoria përkatëse. Nga cila drejtori bëhet mbikëqyrja e dhënies në shfrytëzim të pronës, nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik apo Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim, këtë propozim vendim e qes në votim dhe i njëjti u aprovua me **22 vota Për, 3 abstenime dhe vota kundër nuk ka**. Me këtë konstatoj që Kuvendi i komunës mori këtë :

#### **VENDIM**

**Për formimin e Komisionit të Ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, me këtë përbërje:**

- 1. Zekir Selimi- nga Ekzekutivi i komunës;**
- 2. Fadil Guri-nга Ekzekutivi i komunës;**
- 3. Brahim Imishti- PDK nga Kuvendi i komunës ;**
- 4. Adnan Reka- LVV nga Kuvendi i komunës; dhe**
- 5. Naim Hysa- nga OJQ(shoqëria civile) /Lënda 01Nr.104/02-19963/22.**

**5. Përgjigje nga MBPZHR në kërkesën e Kuvendit të komunës, të datës 28.07.2022, lidhur me rishqyrtimin e vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit 01Nr.60/06-350/02-16605/22, të datës 27.06.2022.**

**z. Agim Mani:** Jemi kundër shfuqizimit të këtij vendimi. Kemi kërkuar plotësim ndryshim të vendimit dhe jo shqyrtim ligjor. Ka pasur gabime të shumta në procesverbalin e komisionit dhe kemi kërkuar të përmirësohen.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne nuk kemi rrugë tjetër të ndryshohet vendimi, sepse është tokë bujqësore. Çka mund të ndryshohet tjetër në këtë aspekt? Edhe kjo në PZHK figuron tokë bujqësore, sikur tokat tjera, nuk e di a ka pasur rrugë tjetër drejtoria për të bërë ndryshim. Ja japim fjalën drejtorit të DUKMM.

**z. Qamil Stagova:** Kam shpresuar të kalohet kjo lëndë, është tokë bujqësore, por është brenda kufijve të zonës urbane, mirëpo nëse nuk është me plan zhvillimor tokë ndërtimore, nuk po lejohet ndërrim destinimi.

**z. Adnan Reka:** Prandaj komisioni është dashur ta cek që është brenda zonës urbane, dhe ajo për mua e bënë plotësim ndryshimin. Brenda zonës urbane dhe jashtë zonës urbane janë dy gjëra komplet ndryshe. Prandaj është dashur të bëhet plotësim ndryshim i duhur, se po të ishte bërë plotësim ndryshimi i duhur atëherë ministria do ta kishte miratuar.

**z. Qamil Stagova:** Jemi takuar me zyrtarët e ministrisë përkatëse, kam dhënë sqarime por nuk ka kaluar.

**z. Besnik Salihu:** Ne nuk e kemi materialin për këtë pikë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** bëhet fjalë për një vendim të mbledhjes së parafundit që na ka kthyer përgjigje ministria dhe përgjigja është kthyer me vonesë dhe ne prapë duhet ta trajtojmë se është kërkesë e ministrisë. Vendimi ka të bëjë me Blerim (Ajet)Çaka nga fshati Bob. A keni dikush tjetër për diskutim rreth kësaj pike ?

Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim, atëherë Përgjigje nga MBPZHR në kërkesën e Kuvendit të komunës, të datës 28.07.2022, lidhur me rishqyrtimin e vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit 01Nr.60/06-350/02-16605/22, të datës 27.06.2022, e qes në votim për anulim të vendimit 01Nr.60/06-350/02-16605/22, e njëjtë votohet me **12 vota Për, 13 vota kundër dhe abstenim nuk ka**. Me këtë konstatojmë që Kuvendi i komunës mori këtë

## VENDIM

**Për Refuzimin e Kërkesës së MBPZHR lidhur me rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të komunës të datës 28.07.2022 dhe Vendimin e datës 27.06.2022/Lënda 01Nr.60/01-25152/22.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të ndalen në zyrën time për një diskutim. Mbledhja i përfundoi punimet në ora 11:50

Procesmbajtëse  
Arbnora Kuka



Kryesues i Kuvendit  
Kemal Murseli

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e VIII (tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, mbajtur me 02.09.2022:**

1. Kemal Murseli .....,
2. Brahim Imishti.....,.....,
3. Hamide Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva .....,
5. Fitore Vishi,.....,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,.....,
7. Edon Baftiu .....,.....,.....,
8. Selajdin Troni .....,.....,.....,
9. Fatmir Bunjaku .....,.....,.....,
- 10.Bashkim Krasniqi .....,.....,.....,
11. Florina Lika-Vishi .....,.....,.....,
12. Lejla Muhamheri-Çaka.....,.....,
13. Agim Mani .....,.....,.....,
14. Kadrije Lika-Troni .....,.....,.....,
15. Adnan Reka .....,.....,.....,
16. Naim Beça .....,.....,
17. Raif Kasa .....,.....,.....,
18. Ernesta Krasniqi,.....,.....,
19. Bashkim Luma .....,.....,.....,
20. Arta Avdiu .....,.....,.....,
21. Arditra Rahmani .....,.....,.....,
22. Besnik Salihu .....,.....,.....,
23. Betim Shala,.....,.....,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,.....,.....,
25. Rabije Sallahi.....,.....,.....,
26. Ekrem Livoreka.....,.....,.....,
- 27.Agim Çaka.....,.....,.....,



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 23.09. 2022

Për: Anëtarët e Kuvendit: z. Adnan Reka,  
z. Agim Mani,  
z. Naim Beqa

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 02. 09. 2022, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

**z. Adnan Reka:** Kam një pyetje për Drejtorin e DSHPE. A mund të na tregoni në Bulevardin “Ismail Raka”, cili është projekt që po zhvillohet rrith lumit “Nerodime” dhe cili është plani pas prishjes së objektit të Qendrës për Punë Sociale? Mund të ktheni përgjigje me gojë ose me shkrim.

- *Referuar pyetjes suaj, ju informoj se aktualisht në bulevardin “Ismajl Raka” është duke u implementuar projekti “Reabilitimi i dy shetitoreve përgjatë lumit Nerodime”- faza I-rë. Në vitin 2022 planifikohet të ridizajnohet Shetitorja nr.3 (punimi i murit mbrojtës, vendosja e ulseve dhe vazove për lule nga materiali i betonit, zgjërimi i shetitoreve dhe vendosja e kubëzave të reja). Kurse hapësira e Objektit të QPS-së, pas rrënimit të saj, është e planifikuar si hapësirë në kuadër të projektit “Ndërtim i Sheshit të qytetit”.*

**z. Agim Mani:** Kemi pasur raste të shumta të simptomave të ujit të kontaminuar. Sipas IKSHPK nga mostrat e ujit të marra, analizat bakteriologjike, kanë treguar se këto mostra nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijshëm. A keni arritur të evidentoni defektet në këto rajone që keni pasur probleme? Nuk kamë parë asnë njoftim publik që komuna ka dal me komunikatë sa i përket këtij evidentimi .Ky ujë shkakton probleme shëndetësore tek qytetarët.

- *Në rrjetin e ujësjellësit Dubravë-Doganaj-Elezaj-Rekë-Soponicë dhe Nikaj janë vendosur klorinatorët për klorizim të ujit të pijshëm, janë rehabilituar defektet në objektet përcjellëse (rezervuare dhe peshoren kryesore është ujit në Sepetin) dhe ky rrjet i ujësjellësit është në monitorim dhe mbikqyrje të vazdueshme nga KRU”Bifurkacioni -njësia e Kaçanikut ndërmarrje e licencuar për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të ujësjellësëve në komunën e Kaçanikut.*

A keni ndonjë kriter për vendosjen e pengesave në rrugë, kur KKSB del me rekomandime që aty ku ka trotuar, të hiqen pengesat në rrugë, ndërsa ju i vendosni edhe aty ku janë dy anët trotuar. Përveç kësaj i kushton edhe buxhetit të komunës njëherë t'i vendosni pastaj t'i rrënoni.


- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, prioritet për vendosjen e barrierave (policëve të shtrirë,) i kushton rrugëve afër objekteve publike me frekuentim të madh të këmbësorëve dhe qasje direkte në rrugë publike (shkollat, ambulanca, institucione parashkollore, etj.) kurse për shqyrtimin e kërkeseve e qytetarëve apo lokaliteteve për vendosjen e barirerave në rrugë të caktuara ekziston komisioni komunal i cili rekomandon drejtorinë për vendosjen apo mosvendosjen e barrierave sipas kërkësës së palëve.

**z. Naim Beqa:** Përvendetje për të gjithë. Me sa di unë, në mbledhjen e parë të Kuvendit ,kam kërkuar vendosjen e pengesave te "ETC" dhe kam kërkuar të vendoset një laurë në hekurudhë, për kalimin e nxënësve të shkollës fillore. A është ndërmarrë ndonjë hap nuk e di , por tash është rasti i komunës të bëjë kërkësë për realizimin e këtij projekti, pasi që aty është rrezik permanent për këto fëmijë.

- Vendosja e pengesave në rrugë (policëve të shtrirë) në rrugën "Ismail Raka" segmenti nga "Ura e Hazirit" deri të udhëkryqi me rrugën "Skenderbeu" dhe "Emsale Frangu" ka trotuar për këmbësor dhe nuk ka rrezik permanent nga automjetet kurse për vendosjen e laurës te ky udhëkryq ku kalon edhe shiriti i hekurudhës jemi në kontakt me përgjegjësitë e Hekurudhave të Kosovës dhe në vazhdimësi i kemi paraqitur edhe me shkrim nevojnë për vendosjen e një laure.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani  
Drejtës i DSHPE-s